



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 166/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Kamenicë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Kamenicë, për shkak të vendosjes posterive dhe flamujve partiak në rrugë publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 09.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Kamenicë, kështu që subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Kamenicë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 5100 (pesëmijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datën 03.10.2013, nga LVV-ja, me të cilën pretendohet se me 04 tetor 2013 në rrugën “ Skënderbeu ” në Kamenicë te rrethrotullimi afër tregut të qytetit, anëtarë të subjektit politik AKR kanë vendosur flamuj të subjektit politik AKR në shenja publike të trafikut. Parashtruesi i ankesës thekson se me këtë rast është bërë shkelje e Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, dhe neni 33 pika b) i IZP-së. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik AKR në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 05.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 07.10.2013, në ora 12:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AKR në të cilën deklaroi se subjekti politik AKR në asnjë rast nuk ka bërë vendosjen e flamujve në shenjat publike të trafikut, ndërsa flamujt e vendosur të cilët i janë bashkangjitur ankesës janë të pabazuara pasi që këtë gjë mund ta bëjë çdokush dhe se me këtë rast propozon që ankesa të hidhet si e pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se si flamujt e subjektit politik AKR janë të vendosura në shenjat publike të trafikut, gjë që e bënë përgjegjëse subjektin politik AKR, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në shenjat publike të trafikut.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Në përgjigje të ankesës nga subjekti politik AKR, përveç thënieve se nuk kanë njohuri se kush i ka vendosur flamujt në fjalë, nuk ka ofruar asnjë dëshmi që ka ndërmarr veprime konkrete për evitimin e shkeljes së supozuar.

Subjekti politik AKR në përgjigje të ankesës nuk ka paraqitur provë asnjë pranë PZAP-it që të tregoj se ka bërë përpjekje serioze për të parandaluar shkeljen e këtij Kodi siç kërkohet me nenin 32.6 të LZP-së.

PZAP-i duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës PZAP-i konstaton se subjekti politik AKR në këtë rast ka thyer kodin e mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët nenit 33 pika b të LZP-së. PZAP-i, duke u bazuar në nenin 32.2 lidhur më nenin nenit 120 paragrafi 1 pika (c) të LZP-së dhe nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 “Për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave” të PZAP-it, po ashtu në kuptim të nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 166/2013 më datën 09.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*